

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Raportimi Financiar i Avancuar**

**P9**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 24.9.2022

1. Më poshtë janë pasqyrat e pozitës financiar për tri kompani me 31 dhjetor 2021.

**Pasqyrat e pozitës financiare me 31 dhjetor 2021**

	<b>Palisa sh.a</b>	<b>Rubin sh.a</b>	<b>Bessel sh.a</b>
	<b>€'milion</b>	<b>€'milion</b>	<b>€'milion</b>
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>			
Pasuritë e patun., imp.e prodhimit dhe paisjet	3,200	1,700	1,200
Invesimet	<u>4,500</u>	<u>2,600</u>	<u>200</u>
	7,700	4,300	1,400
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>			
Stoqet	1,000	400	300
Të arkëtueshmet tregtare	960	420	100
Paraja & banka	<u>730</u>	<u>100</u>	<u>100</u>
	<u>2,690</u>	<u>920</u>	<u>500</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>10,390</b>	<b>5,220</b>	<b>1,900</b>
<i>Ekuiteti:</i>			
Aksionet e zakonshme pre €1 secila	5,000	1,250	800
Rezreva e rivlerësimit	2,400	830	500
Fitimet e mbajtura	<u>780</u>	<u>800</u>	<u>450</u>
	8,180	2,880	1,750
<i>Detyrimet afatshkurtëra:</i>			
Të pagueshmet tregtare	1,000	1,100	120
Tatimi	<u>1,210</u>	<u>1,240</u>	<u>30</u>
	<u>2,210</u>	<u>2,340</u>	<u>150</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>10,390</b>	<b>5,220</b>	<b>1,900</b>

Informatat në vijim janë të rëndësishme:

- i) Palisa sha bleu 750 milionë aksione në Rubin sh.a më 1 janar 2020, me një kosto prej €2.00 për aksion të paguar në para të gatshme. Në atë datë, fitimet e pashpërndara të Rubin sh.a ishin €500 milionë dhe rezerva e rivlerësimit ishte €300 milionë. Pasuritë neto të Rubin ishin të barabarta me vlerat kontabël të tyre. Disa zërave të pasurive afatgjata materiale, kishin një vlerë të drejtë prej €300 milionë mbi vlerën e tyre sipas koston historike dhe kjo vlerë është e përfshirë në rezervën e rivlerësimit.
- ii) Palisa ka një politikë të mbajtjes së pasurive e patundshme, impianteve të prodhimit dhe paisjet me vlerën e drejtë. Kjo politikë zbatohet në të gjitha kompanitë e grupit që nga data e blerjes. Prandaj, vlerat e drejta janë përfshirë në librat e Rubin sh.a në datën e blerjes dhe zhvlerësmi është aplikuar ashtu siç duhet.
- iii) Më 1 janar 2021, Rubin sh.a bleu 640 milionë aksione në Bessel sh.a. Shuma për blerjen ishte €4 për aksion në para të gatshme. Përveç kësaj, u ra dakord që një pagesë e mëtejshme prej €1 për aksion do të bëhej më 31 dhjetor 2022 nëse fitimet tejkalojnë pritjet. Vlera e drejtë e këtij komponenti të shumës ishte €360 milionë më 1 janar 2021 dhe €420 milionë

më 31 dhjetor 2021. Pagesa me para para të gatshme u regjistrua në librat e Rubin sh.a-së, por nuk u bë asnjë regjistrim për të regjistruar elementin kontingjent të çmimi të blerjes. Më 1 janar 2021, rezerva e fitimeve të mbajtura të Bessel sh.a ishte €550 milionë dhe rezerva e rivlerësimit ishte €260 milionë. Bessel sh.a ka pasur gjithmonë një politikë të matjes së së pasurive e patundshme, impianteve të prodhimit dhe paisjet me vlerën e drejtë, prandaj vlerat kontabël të këtyre pasurive ishin të barabarta me vlerat e tyre të drejta në datën e blerjes.

- iv) Bessel kontrollon një markë tregtare të famshme "Orion", e vlerësuar të ketë një jetë të dobishme ekonomike prej 20 vjetësh nga 1 janari 2021 me një vlerë të drejtë në të njëjtën datë prej €100 milion. Kjo nuk është njohur në librat kontabël.
- v) Palisa sh.a-së matë interesin jo-kontrollues në Rubin sh.a me vlerën e drejtë në datën e blerjes. Për këtë duhet të përdoret çmimi i aksionit prej €2.00. Palisa sh.a matë interesin jo-kontrollues në Bessel sh.a me pjesën e tij proporcionale të pasurive neto të identifikueshme në datën e blerjes.
- vi) Më 31 dhjetor 2021, zëri i mirë u vlerësua për dëmtim dhe llogaritja tregoi se një humbje nga dëmtim prej €50 milion do të njihej në zërin e mire të Rubin sh.a-së dhe €30 milion në zërin e mire të Bessel sh.a-së. Asnjë humbje nga dëmtimi nuk ishte njohur deri më 31 dhjetor 2021.
- vii) Gjatë vitit, Rubin sh.a bleu mallra nga Bessel sh.a për një shumë totale prej €20 milionë. Këto mallra i kushtuan Bessel sh.a-së €15 milionë. 60% e mallrave mbetën të pashitura nga Rubin sh.a në datën e raportimit.

**Kërkohet:**

**Përgatitni pasqyren e konsoliduar të pozitës financiare për Grupin Palisa për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021 në përputhje me SNRF-të. (25 pikë)**

1.

**Grupi Palisa****Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare me 31 dhjetor 2021****€ milion****Pasuritë***Pasuritë jo-qarkulluese:*

Pasuritë e patun., imp.e prodhimit dhe paisjet (3,200 + 1,700 + 1,200)	6,100
Investimet tjera (4,500 + 2,600 + 200 - 1,500 L12 - 2,560 L12)	3,240
Marka tregtare (100 - 5) L12	95
Zëri i mire (400 + 901.20) L12	<u>1,301.20</u>
	10,736.20

*Pasuritë qarkulluese:*

Stoqet (1,000 + 400 + 300 - 3 L15)	1,697
Të arkëtueshmet tregtare (960 + 420 + 100)	1,480
Paraja & banka (730+100+100)	<u>930</u>
	<b>4,107</b>

**Total pasuritë****14,843.20***Ekuiteti:*

Aksionet e zakonshme pre €1 secila	5,000
Rezerva e rivlerësimit (L16)	2,833.2
Fitimet e mbajtura (L13)	<u>812.16</u>
	8,645.36
Interesi jo-kontrollues (120 + 957.84)L14	<u>1,077.84</u>
	9,723.20


*Detyrimet afatshkurtëra:*

Të pagueshmet tregtare (1,000 + 1,100+ 120)	2,220
Tatimi (1,210 + 1,240 + 30)	2,480
Konsiderata kontigjente	<u>420</u>
	<u>5,120</u>

**Total ekuiteti dhe detyrimet****14,843.20**

## Llogaritjet:

### L11 Struktura e grupit



<u>Përmbledhje e përqindjeve</u>	<b>Rubin</b>	<b>Bessel</b>
Prindi% - Direkt	60%	-
Indirekt	-	(60% x 80%) 48%
IJK %	<u>40%</u>	<u>52%</u>
	100%	100%

### L12 Zëri i mirë

	<b>€ milion</b>
Rubin (Sipas vleres se drejtë)	
Kosto e investimit (750 x 2)	1,500
VD E IJK në blerje ((1,250 - 750) x 2)	<u>1,000</u>
	2,500
VD e PN te identifikueshme	
Aksionet e zakonshme	(1,250)
Rezerva e rivleresimit	(300)
Fitimet e mbajtura	(500)
Korigjimet e VD - shënim ii në detyrë	<u>(0)</u>
	<u>(2,050)</u>
Zëri i mirë në blerje	450
Dëmtimi	<u>(50)</u>
<b>Zëri i mirë në daten e raportimit</b>	<b>400</b>
Bessel (sipas pjeses proporcionale)	
Kosto e investimi:	
Para (640 x 3)	2,560
Konsiderata kontigjente	<u>360</u>
	2,920
Minus pronësia indirekte: (40% x 2,920)	(1,168)
IJK në blerje (52% x 1,710 (L12))	<u>889.2</u>
	2,641.2
VD e PN te identifikueshme	

Aksionet e zakonshme	(800)	
Teprica e rivleresimit	(260)	
Fitimet e mbajtura	(550)	
Korigjimet e VD (marka tregtare)	<u>(100)</u>	
		<u>(1,710)</u>
Zëri i mirë në blerje		931.2
Dëmtimi		<u>(30)</u>
<b>Zëri i mirë në daten e raportimit</b>		<b>901.2</b>

### L13 Fitimet e mbajtura

	Palisa sh.a €'milion	Rubin sh.a €'milion	Bessel sh.a €'milion
Sipas pyetjes	780	800	450
Para blerjes		<u>(500)</u>	<u>(550)</u>
Pas blerjes		300	(100)
Konsiderata kontigjente (420 - 360)		<u>(60)</u>	
Amortizimi i markës tregtare (100/20)			(5)
FPR (L15)			<u>(3)</u>
		240	(108)
Pjesa e Rubin (300 x 60%)	144		
Pjesa e Bessel (-108 x 60% x 80%)	(51.84)		
Dëmtimi i ZM në Rubin (60% x 50)	(30)		
Dëmtimi i ZM në Besel (60% x 80% x 30)	<u>(30)</u>		
	<b>812.16</b>		

### (L14) Interesi jo-kontrollues

	€'milion
Rubin (sipas vlerës së drejtë)	
VD e IJK në blerje (L12)	1,000
Shto: IJK % FM (40% x 240) L12	96
Shto: IJK e RR (L15)	212
Minus: IJK% e dëmtimit (40% x 50) L12	(20)
Korigjimi në pronësi indirekte (L1 2)	<u>(1,168)</u>
<b>Në daten e raportimit</b>	<b>120</b>

Bessel (sipas pjeses proporcionale)	
IJK në blerje (L13)	889.2
Shto: IJK % FM: (52% x -108)	(56.16)
Shto: IJK e RR (52% x 240)	<u>124.8</u>
<b>Në daten e raportimit</b>	<b>957.84</b>

### L15 Fitimi i perealizuar

(20 mil - 15 mil) x 60% = 3 mil

**(L16) Rezerva e rivleresimit****€'milion**Palisa

Saldo ne fillim

2,400

Rubin

Pjesa e prindit pas blerjes (60% x (830 - 300))

318

Bessel

Pjesa e prindit pas blerjes (48% x (500-260))

115.2**Në daten e raportimit****2,833.2**

2.

a) Me 1 janar 2016 Hoyle sh.a bleu një pronë për €4,000,000 dhe zhvlerësimi vjetor prej €200,000 (për 20 vite, vlerë të mbetur zero dhe nuk ka tokë por vetëm ndërtesë) ngarkohet në bazë lineare. Në fund të vitit financiar të mëparshëm me 31 dhjetor 2020, kur zhvlerësimi i akumuluar ishte €1,000,000, u njoh një humbje prej €300,000 për shkak të dëmtimit dhe prona u vlerësua me vlerën e saj të rkuperushme.

Më 1 korrik 2021, si pasojë e një lëvizjeje të propozuar në ambiente të reja, prona u klasifikua si e mbajtur për shitje. Në kohën e klasifikimit si të mbajtur për shitje, vlera e drejtë minus kostot e shitjes ishte €2,000,000. Në datën e raportimit të pasqyrave financiare të ndërmjetme me 30 shtator 2021, tregu i pronës ishte përmirësuar dhe vlera e drejtë minus kostot për shitje u rivlerësua në €2,300,000 dhe në fund të vitit më 31 dhjetor 2021 ishte përmirësuar edhe më tej, kështu që se vlera e drejtë minus kostot e shitjes ishte €3,000,000. Prona u shit më 5 qershor 2022 për €3,200,000.

**Kërkohet:**

**Tregoni se si ngjarjet e mësipërme duhet të paraqiten në pasqyrat financiare të Hoyle sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021. (8 pikë)**

b) Në 1 janar 2019 Tinsley sh.a akordon 50 kontrata me mundësi zgjedhjeje për aksione (opciione) për çdo punonjës që e kishte. Secili akordim është i kushtëzuar me faktin që punonjësi duhet të punojë për entitetin deri në 31 dhjetor 2021. Vlera e drejtë e secilës kontratë me mundësi zgjedhjeje për aksione (opcion) është €30.

Me 1 janar 2019 Tinsley sh.a kishte 500 punonjës. Gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021 Tinsley sha kishte këto largime dhe parashikime të largimeve të punonjësve:

1. Gjatë vitit 2019, 30 punonjës kanë lënë punën dhe Tinsley sh.a vlerëson se në total 10% e punonjësve që ju janë akorduar kontratat do ta lënë punën gjatë gjithë periudhës tre vjeçare.
2. Gjatë vitit 2020 edhe 40 punonjës të tjerë lënë punën dhe Tinsley sh.a tani vlerëson total 15% e punonjësve që ju janë akorduar kontratat do ta lënë punën gjatë gjithë periudhës tre vjeçare.
3. Gjatë vitit 2021 edhe 30 punonjës të tjerë lënë punën.

**Kërkohet**

**Llogaritni shpenzimet e pagesave të punonjësve që do të duhet të njihen për sa i takon transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione për secilin prej tre vjetëve të periudhës që mbaron në 31 dhjetor 2019, 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2021. (7 pikë)**



## 2.

a) Në vlerësimin e pronës, Hoyle sh.a duhet të aplikoj kërkeast e SNRF 5 *Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera*. Menjëherë pas klasifikimit fillestar si pasuri jo-qarkulluese e mbajtur për shitje, vlera kontabël e pasurisë duhet të matet në përputhje me SNRF 5. Pas klasifikimit si të mbajtur për shitje, prona duhet të matet me vlerën më të ulët midis vlerës kontabël dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Dëmtimi duhet të konsiderohet si në momentin e klasifikimit si të mbajtur për shitje dhe më pas në përputhje me SNRF 5. Çdo humbje nga dëmtimi njihet në fitim ose humbje, përveç rastit kur pasuria është matur më parë me një shumë të rivlerësuar sipas SNK 16 *Pasuritë e patundshme, impajnet e prodhimit dhe paisjet* ose SNK 38 *Pasuritë e patrupëzuara*, në të cilin rast dëmtimi trajtohet si një zvogëlim i rivlerësimit. Një fitim për çdo rritje të mëvonshme në vlerën e drejtë minus kostot e shitjes së një pasurie njihet në fitim ose humbje në masën që nuk është më i madh se humbja kumulative nga dëmtimi e cila është njohur në përputhje me SNRF 5 ose më parë në përputhje me SNK 36 *Dëmtimi i pasurive*.

Në momentin e klasifikimit si të mbajtur për shitje, zhvlerësimi duhet të ngarkohet për 6 muajt deri më 1 korrik 2021. Kjo do të bazohet në vlerën e fundit të vitit në 31 dhjetor 2020 prej 2,700,000. Prona ka 15 vjet jetë të mbetur dhe duke supozuar një vlerë të mbetur zero, zhvlerësimi për 6 muaj muajt do të jetë €90,000  $((3,000,000 - 300,000)/15 \text{ vite}/12 \text{ muaj} \times 6 \text{ muaj})$ .

Kështu, në momentin e klasifikimit si të mbajtur për shitje, pas ngarkimit të zhvlerësimit për €90,000, vlera kontabël është €2,610,000  $(€3,000,000 - €300,000 - €90,000)$  dhe vlera e drejtë minus kosto për të shitur vlerësohet në €2,000,000. Rrjedhimisht, regjistrimi i dëmtimit është €610,000 dhe prona mbartet në €2,000,000.

Më 30 shtator 2021 në pasqyrat financiare të ndërmjetme, tregu i pronës është përmirësuar dhe vlera e drejtë minus kostot e shitjes është rivlerësuar në €2,300,000. Rritja pre €300,000 është më i vogël se humbjet kumulative nga dëmtimi të njohura deri më këtë datë €910,000  $(300,000 + 610,000)$ . Prandaj, kreditohet në fitim ose humbje dhe prona mbartet në €2,300,000.

Më 31 dhjetor 2021, tregu i pronave ka vazhduar të përmirësohet dhe vlera e drejtë minus kostot për shitje tani vlerësohet në €3,000,000. Perfitimi i mëtejshëm prej €700,000 është, megjithatë, më i madh se humbjet kumulative nga dëmtimi të njohura deri më këtë datë  $(300,000 + 610,000 - 300,000)$ . Prandaj, një fitim i kufizuar prej €610,000 kreditohet në fitim ose humbje dhe prona mbartet në €2,910,000. Më pas, prona shitet për €3,200,000 në të cilën pikë njihet një përfitim prej €290,000. Kjo shitje do të ishte një ngjarje jo rregulluese sipas SNK 10 *Ngjarjet pas Periudhës së Raportimit* nëse konsiderohet të jetë materiale.

b) SNRF/ IFRS 2 kërkon që entitetet të njohin [kontabilizojnë] shpenzimet e kompensimit, duke u bazuar mbi vlerën e drejtë të kontratave me mundësi zgjedhjeje për aksione (opcioneve) të dhëna si kompensim, gjatë gjithë kohës që përftohen shërbimet në fjalë, pra gjatë periudhës tre vjeçare deri në përfitim të titullit.

Në vitet 2019 dhe 2020 Tinsley sh.a vlerëson numrin e kontratave me mundësi zgjedhjeje për aksione (opcione) që pritet të fitojnë përfitim të titullit (duke vlerësuar numrin e punonjësve që ka mundësi të largohen) ndërsa shumën e njohur [kontabilizuar] e bazon mbi këtë vlerësim.

Në vitin 2021 Tinsley sh.a kontabilizon një shumë e cila bazohet mbi numrin e kontratave me mundësi zgjedhjeje për aksione (opcione) për të cilët është përftuar aktualisht titulli. Gjatë

periudhës tre vjeçare janë larguar gjithsej 100 punonjës dhe për këtë arsye është fituar titulli për 20,000 kontrata me mundësi zgjedhjeje për aksione (opcione) (500 – 100 x 50).

Shuma e njohur si një shpenzim për secilin prej këtyre tre viteve do të duhet të llogaritet si vijon:

		<b>Shpenzimi i akumuluar në fund të vitit</b>	<b>Shpenzimi për vitin</b>
		<b>€</b>	<b>€</b>
2019	$500 \times 50 \times 90 \% \times 30 \times 1/3$	225,000	225,000
2020	$500 \times 50 \times 85 \% \times 30 \times 2/3$	425,000	200,000
20X3	$400 \times 50 \times 100\% \times 30 \times 3/3$	600,000	175,000

3.

a) Më 1 janar 2016, Aryabhata sh.a hapi një shkollë me një kosto prej €1,000,000. Jeta e dobishme e vlerësuar e shkollës ishte 25 vjet. Më 31 dhjetor 2021, shkolla u mbyll sepse numri i nxënësve ra dukshëm për shkak të emigracionit. Shkolla do të shndërrohet për t'u përdorur si depo e mallrave dhe nuk pritet që ndërtesa do të ripëdoret si shkollë. Kostoja aktuale bruto e zëvendësimit për një depo të mallrave me madhësi të barabartë me shkollën është €200,000. Për shkak të natyrës së pasurisë afatgjatë, vlera në përdorim dhe çmimi neto i shitjes janë vlerësime joreale të vlerës së shkollës. Ndryshimi në përdorim nuk do të kishte efekt në jetëgjatësinë e parashikuar të ndërtesës.

**Kërkohet:**

**Tregoni se si duhet të kontabilizohet ngjarja e mësipërme në pasqyrat financiare të Aryabhata sh.a-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021. (tregoni llogaritjet) (5 pikë)**

b) Të gjithë profesionistët në fushën e kontabilitetit kanë përgjegjësinë për të vepruar në interes të publikut dhe për të promovuar etikën profesionale. Drejtorët e Riccioli sh.a kanë deklaruar "se gjatë menaxhimit të kompanisë objektivi i arritjes së fitimit mund të jetë në kundërshtim me interesin e publikut, dhe ndonjëherë nuk mund të jetë etik, por realizimi i fitimeve mbetet më e rëndësishme se kodi i etikës dhe Riccioli sh.a mund të raportoj fitime më të larta edhe nëse nuk janë të sakta".

**Kërkohet:**

**Diskutoni deklaratën e mësipërme të drejtorëve të Riccioli sh.a në lidhje me faktin se realizimi dhe raportimi i fitimeve është më e rëndësishme se kodi i etikës. (5 pikë)**

(c) Drejtorët e Beer sh.a kanë paqartësi për disa çështje që lidhen me SNK 7 Pasqyra e rrjedhjeve të parasë të gatshme. Ata dëshirojnë të dijnë më shumë për rëndësinë e pasqyrës së rrjedhjeve të parasë. Beer sh.a ka afatizuar në bankë paratë si mëposhtë pas fundit të vitit dhe drejtorët dëshirojnë të dijnë se si trajtojnë këto transaksione në pasqyrën e rrjedhjeve të parasë të gatshme:

- (i) €5 milionë në një llogari të afatizuar me afat 6 muaj më normë të interesit prej 1%. Këto para mund të tërhiqen me paralajmërim prej 7 ditëve, por Beer sh.a do të pësojë një gjobë, e cila është e barabartë me humbjen e të gjithë interesit të fituar.
- (ii) €10 milionë në një llogari të afatizuar me afat 6 muaj më normë të interesit prej 2.5%. Paratë mund të tërhiqen duke paralajmëruar 30 ditë. Interesi do të paguhet për periudhën e depozitës, por nëse paratë tërhiqen, interesi do të llogaritet me 2.4%, që është e barabartë me normën e deklaruar të bankës për depozitat afatshkurtra. Beer sh.a është i bindur se nuk do t'i duhet të tërheqë paratë nga depozita brenda afatit, por dëshiron të mbajë qasje më të lehtë në këto €10 milionë për të mbuluar çdo vështirësi financiare që mund të lindë.

**Kërkohet:**

**Diskutoni parimet e klasifikimit në pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, dhe këshilloni Beer sh.a se si të trajtohen dy depozitat e mësipërme në pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme. (10 pikë)**

a) Një pasuri mbartet me shumën e tij e rikuperueshme nëse vlera kontabël e tij tejkalon shumën që do të rikuperohet nëpërmjet përdorimit ose shitjes së pasurisë. Nëse është kështu, pasuria trajtohet si e dëmtuar dhe SNK 36 *Dëmtimi i pasurive* kërkon njohjen e një humbjeje nga dëmtimi. Në fund të çdo periudhe raportuese, duhet të bëhet një vlerësim nëse ka ndonjë tregues që një pasuri mund të jetë e dëmtuar. Nëse ekziston ndonjë tregues, shuma e rikuperueshme duhet të vlerësohet duke marrë parasysh konceptin e materialitetit në identifikimin nëse shuma e rikuperueshme e një pasurie duhet të vlerësohet. Nëse nuk ka asnjë tregues të një humbjeje nga dëmtimi, SNK 36 nuk kërkon një vlerësim zyrtar të shumës së rikuperueshme, me përjashtim të pasurive jo-materiale.

Në këtë rast ka indikacion dëmtimi sepse qëllimi për të cilin përdoret ndërtesa ka ndryshuar ndjeshëm nga një vend për edukimin e nxënësve në një depo mallrash dhe kjo nuk parashikohet të ndryshojë në të ardhmen e parashikueshme. Nuk ka informacion të mjaftueshëm për të përcaktuar vlerën në përdorim dhe çmimin neto të shitjes (vlera e drejtë minus kostot e shitjes); si e tillë, kostoja e zëvendësimit të amortizuar duhet të përdoret si një përafrim i shumës së rikuperueshme. Me 31 dhjetor 2021 një humbje nga dëmtimi duke përdorur metodën e kostos së zëvendësimit të amortizuar do të përcaktohet si më poshtë:

<b>Pasuria</b>	<b>Kosto €'000</b>	<b>Zhv i akumuluar €'000</b>	<b>Vlera bartëse €'000</b>
Shkolla	1,000	(240)	760
Depo mallrash	200	(48)	<u>152</u>
Humbja nga dëmtimi (760-152)			608

Kështu që Aryabhata sh.a do të regjistroj humbjen nga dëmtimi prej €608,000.

b) Drejtorët duhet të binden se etika profesionale është një pjesë e qenësishme e profesionit të kontabilitetit, si dhe profesioneve të tjera. Etika profesionale është një grup standardesh morale të zbatueshme për të gjithë profesionistët. Çdo organ profesional ka kodin e tij etik siç është Kodi i Etikës dhe Sjelljes së ShKÇAK, i cili kërkon që anëtarët e tij t'i përmbahen një sërë parimesh themelore gjatë kryerjes së detyrës së tyre profesional si, integriteti, objektiviteti, kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur, dhe konfidencialiteti dhe sjellja profesionale.

Shpesh mund të ketë parime etike që bien ndesh me motivin e fitimit dhe mund të jetë e vështirë të vendoset për një kurs veprimi. Një kontabilist ka një detyrim etik për të inkurajuar drejtorët që të veprojnë brenda kufijve të caktuar kur raportojnë shumën e fitimit. Përdoruesit e pasqyrave financiare po bëhen reagues ndaj sjelljeve joetike të drejtorëve. Kjo po shpie në investime më të mëdha në kompanitë etike dhe si rezultat praktiket etike kanë një ndikim më të madh në vlerën e Riccioli sh.a-së sesa raportimi i një shifre fitimi më të lartë.

Mungesa apo largimi i investitorëve mund të ketë ndikim shumë negativ në performacën dhe mbijetesën e Riccioli sh.a-së. Kjo jo vetëm që ka pasoja serioze personale për individët, duke filluar nga humbja e punës dhe dëmtimi i reputacionit deri te gjobat dhe madje edhe burgimi, por sjellja joetike nga pjesëmarrësit e tregut, profesionistët e investimeve dhe ata që u shërbejnë investitorëve mund të dëmtojnë besimin e investitorëve dhe në këtë mënyrë të dëmtojnë qëndrueshmërinë e tregjeve globale të kapitalit në tërësi.

Shoqëria përfundimisht përfiton nga tregjet efikase ku kapitali mund të rrjedhë lirshëm drejt destinacionit më produktiv ose inovativ. Tregjet e kapitalit që funksionojnë mirë përputhin në mënyrë efikase ata që kanë nevojë për kapital me ata që kërkojnë të investojnë kapitalin e tyre në kompani që gjenerojnë të ardhura. Në mënyrë që tregjet e kapitalit të jenë efikase, investitorët duhet të jenë në gjendje të besojnë se tregjet janë të drejta dhe transparente dhe t'u ofrojnë atyre mundësinë për t'u shpërblyer për rrezikun që ata zgjedhin të marrin.

c) Përdorimi i pasqyrës së rrjedhjeve të parasë së gatshme është shumë i lidhur me atë të pjesës tjetër të pasqyrave financiare.

Përdoruesit mund të vlerësojmë më mirë ndryshimet në pasuritë neto, në pozicionin financiar të entitetit (likuiditeti dhe aftësia për të paguar) dhe kështu aftësinë e entitetit për t'iu përshtatur ndryshimit të rrethanave, duke rregulluar shumat dhe kohën e rrjedhjeve të parasë së gatshme. Pasqyra e rrjedhjeve të parasë së gatshme rrit mundësinë e krahasimit për shkak se rrjedhjet e parasë së gatshme nuk ndikohen prej politikave të kontabilitetit që përdoren për trajtimin e të njëjtit lloj të transaksioneve ose ngjarjeve.

Informacionet për rrjedhjet e parasë së gatshme meqenëse kanë një natyrë historike mund të përdoren si një tregues i shumave monetare, i kohës dhe sigurisë së rrjedhjeve të ardhshme të parasë së gatshme. Informacionet e shkuara parashikuese të rrjedhjeve të parasë së gatshme mund të kontrollohen për të konfirmuar saktësinë me shifrat aktuale. Marrëdhënia midis fitimit dhe rrjedhjeve të parasë së gatshme mund të analizohet për të parë se si mund të ndryshohen çmimet me kalimin e kohës.

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në dorë dhe depozitat pa afat, së bashku me investimet afatshkurtra, likuide, të cilat janë lehtësisht të konvertueshme në një shumë të njohur të mjeteve monetare dhe që janë subjekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerë. SNK 7 nuk përkufizon "afatshkurtër" por thotë "një investim normalisht kualifikohet si një ekuivalent i mjeteve monetare vetëm kur ka një maturim të shkurtër, le të themi, tre muaj ose më pak nga data e blerjes". Ky afat kohor tre mujor është disi arbitrar, por është në përputhje me konceptin e rrezikut të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerë dhe me qëllimin e përmbushjes së angazhimeve afatshkurtra në para.

Për sa i përket depozitave ky është sqarimi:

(i) Megjithëse kryegjëja €5 milionë do të rikuperohet me tërheqje të hershme, Beer sh.a do të humbasë të gjithë interesin e akumuluar gjatë afatit, që duket të jetë një gjobë e rëndësishme. Paratë e gatshme nuk janë të nevojshme për të përmbushur angazhimet afatshkurtra të parave të gatshme dhe kështu nuk do të kualifikohen si ekuivalent i parasë së gatshme.

(ii) Edhe pse deklarohet se depozita ka një periudhë maturimi 6 mujore, ajo mund të tërhiqet me njoftim 30 ditësh. Edhe pse kjo sjell një gjobë, ulja e normës së interesit nga 2.5% në 2.4% nuk ka gjasa të konsiderohet e rëndësishme. Synimi i menaxhmentit është t'i mbajë këto fonde në dispozicion për nevojat afatshkurtra të parave të gatshme dhe kështu kjo depozitë ka të ngjarë të kualifikohet si ekuivalent i parasë.

4.

a) Kepler sh.a sponsorizon sportistë në një përpjekje për të përmirësuar imazhin e brendit të tij. Aktualisht, ka një marrëveshje pesëvjeçare me një futbollist që aktualisht renditet në tre futbollistët më të mirë në botë. Sipas marrëveshjes futbollisti do të marrë një bonus prej €10,000,000 me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes dhe do të fitojë një shumë vjetore prej €25,000,000 të paguar në fund të çdo viti për pesë vjet, me kusht që futbollisti të ketë konkurruar në ligen e kampionëve. Nëse futbollisti fiton ligën e kampionëve apo kampionatin nacional, ai merr një bonus prej 20% të çmimit të fituar. Si pjesë e marrëveshjes futbollisti duhet të vendos logot reklamuese në këpucët e tij, dhe të marrë pjesë në video inçizimet për qëllime reklamimi. Pagesat e mesipërme nuk janë të ndërlidhura me njëra tjetrën.

**Kërkohet:**

**Diskutoni se si transaksionet e mesipërme duhet të trajtohen në pasqyrat financiare të Kepler sh.a. (5 pikë)**

b) Më 1 janar 2021 Hypatia sh.a ka marrë një kredi në valutë të huaj prej \$5 milionë me një interes fikse prej 5%. Interesi paguhet në fund të çdo viti. Kredia do të shlyhet pas dy vjetësh më 31 dhjetor 2023.

Hypatia sh.a kërkon këshilla se si të kontabilizojë kredinë dhe interesin në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Kursi mesatar i këmbimit të valutës për vitin nuk është materialisht i ndryshëm nga kursi aktual.

<b>Data</b>	<b>Kurset e këmbimit €1 = \$</b>
1 janar 2021	5
31 dhjetor 2021	6
Kursi mesatar i këmbimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	5.5

**Kërkohet:**

**Tregoni se si kredia e mesipërme duhet të kontabilizohet në pasqyrat financiare të Hypatia sh.a-së. Tregoni edhe llogaritjet. (5 pikë)**

c) Huggins sh.a, një kompani e listuar në bursë, ndërton, zhvillon dhe operon parqe të lojërave zbavitëse. Gjatë vitit financiar deri më 31 dhjetor 2021, një nga lojërat në një park u shemb dhe si pasojë disa persona u lënduan lehtë. Aksidenti rezultoi në mbylljen e këtij parku. Kur po përgatiteshin pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021, hetimi për aksidentin dhe rindërtimi i pjesës së dëmtuar të parkut ishin ende në vazhdim dhe ende nuk ishte iniciuar asnjë veprim ligjor në lidhje me aksidentin. Ekspertiza që do të paraqitej në gjykatat civile për të përcaktuar shkakun e aksidentit dhe për të vlerësuar përgjegjësitë përkatëse të palëve të ndryshme të përfshira, pritej në vitin 2022.

Dëmet financiare që lindin në lidhje me kostot shtesë dhe humbjet operative që lidhen me mosoperimin e parkut zbavitës, natyra dhe shtrirja e dëmeve, si dhe detajet e çdo pagese kompensimi nuk janë përcaktuar ende. Drejtorët e Huggins sh.a menduan se për momentin, nuk kishte asnjë arsye për të regjistruar ndikimin e aksidentit në pasqyrat financiare.

Marrëveshjet e kompensimit ishin kryer me personat e lënduar dhe kërkesat e tyre mbuloheshin të gjitha nga polisa e sigurimit të Huggins sh.a. Në secilin rast, kompensimi i paguar nga kompania e sigurimit ishte subjekt i heqjes dorë nga çdo procedurë gjyqësore kundër Huggins sh.a dhe siguruesve të saj. Nëse ndonjë kompensim përfundimisht i paguhet palëve të treta, kjo pritet të mbulohet nga policat e sigurimit.

Drejtorët e Huggins sh.a mendonin se kushtet për njohjen e një provizioni ose shpalosjen e një detyrimi kontingjent nuk ishin përmbushur. Prandaj, Huggins sh.a nuk njohu një provizion në lidhje me aksidentin dhe as nuk shpalosi ndonjë detyrim kontingjent ose ndonjë shënim shpjegues në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021 që përshkruan natyrën e aksidentit dhe pretendimet e mundshme.

**Kërkohet:**

**Diskutoni se si duhet të trajtohet transaksionet financiare dhe ngjarjet e mësipërme në pasqyrat financiare të Huggins sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021. (5 pikë)**

d) Në 31 nëntor 2021, Ghez sh.a dështoi në pagesën e interesit dhe kryegjësë në shumë prej €200 mijë për një kredi prej €1.5 milionë e ripagueshme në kiste tremujore deri në dhjetor 2023. Marrëveshja e kredisë qartë përcakton që në rast të dështimit të pagesës së kësteve, pra mosrespektimit të kushteve të kredisë, huamarrësi është i detyruar që ta shlyej krejt kredinë. Megjithatë, me 17 janar 2022 banka hoqi dorë nga një kërkesë e tillë dhe e shtyu pagesën e kistit të nëntorit 2021 deri me 28 shkurt 2022 ku do të paguhej gjithashtu edhe kisti i ardhshëm. Ghez sh.a ishte e sigurt se mund të bënte pagesat. Ghez sh.a e klasifikoi kredinë si detyrim afatgjatë në pasqyrën e tij të pozitës financiare më 31 dhjetor 2021 mbi bazën se kredia nuk ishte në vonesa në fund të periudhës raportuese pasi banka hoqi dorë nga kërkesa për të kërkuar shlyerjen e tërë kredisë.

**Kërkohet:**

**Diskutoni se si duhet të trajtohen transaksionet e mësipërme në pasqyrat financiare të Ghez sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021. (5 pikë)**

4.

a)

Pagesat e ndryshme për futbollistin nuk janë të ndërlidhura me njëra tjetrën.

Kontrata lidhet me shpenzimet reklamuese dhe promovuese për të përmirësuar imazhin e markës Kepler sh.a nga futbollisti. Prandaj, në përputhje me SNK 38 *Pasuritë e patrupëzuara*, kostot duhet të shpenzohen kur Kepler sh.a të ketë marrë shërbimin. Çdo shumë e paguar përpara shërbimi të pranohet njihet si parapagim dhe shpenzohet kur ai shërbim merret. Bonusi me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes prej €10,000,000 i paguhet futbollisti në fillimin e kontratës. Në këmbim, futbollisti është i detyruar të reklamojë Kepler dhe të vendos logot reklamuese në këpucët e tij, dhe të marrë pjesë në video inçizimet.

Bonusi me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes lidhet me afatin e plotë të kontratës dhe një parapagim prej €10,000,000 njihet në fillim dhe shpenzohet në bazë lineare gjatë periudhës pesëvjeçare të kontratës. Megjithatë, nëse, nga kushtet e kontratës, shërbime të veçanta mund të identifikohen dhe maten në mënyrë të besueshme, Kepler sh.a duhet të ndajë kostot dhe të njohë shpenzimet pasi të jetë kryer shërbimi i veçantë. Nëse kontrata ndërpritet përpara përfundimit të periudhës së kontratës, çdo shumë e parikthyeshme nga futbollisti do të shpenzohet menjëherë.

Futbollisti merr €25,000,000 në fund të çdo viti, me kusht që të ketë konkurruar në ligën e kampionëve. Kepler sh.a ka një detyrim kontraktual për t'i dhënë futbollisti para dhe, për rrjedhojë, një detyrim financiar gjatë periudhës, i cili duhet të kontabilizohet në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet Financiare*. Detyrimi njihet në momentin kur Kepler sh.a ka një detyrim që lind në datën kur futbollisti ka konkurruar në ligën e kampionëve.

Detyrimi financiar njihet me vlerën e tanishme të rrjedhave të pritshme të pasasë.

Futbollisti gjithashtu merr pagesa shtesë në lidhje me performancën për sukses në ligën e kampionëve apo kampionatin nacional. Duke qenë se këto pagesa lidhen me ngjarje specifike, ato përlllogariten dhe shpenzohen kur futbollisti të ketë fituar ligën e kampionëve ose kampionatin nacional apo të dyjat.

b)

Saldo e kredisë, si zë monetar, përkthehet me kursin e këmbimit spot (të çastit) në datën e fundit të vitit. Interesi përkthehet me normën mesatare sepse përafrohet me normën aktuale. Hypatia sh.a mat kredinë në njohjen fillestare me shumën e marrë të përkthyer në valutën funksionale. Pasi nuk ka kosto transaksioni, norma efektive e interesit është 5%.

Me 1 janar 2021, kredia regjistrohet në njohjen fillestare si më poshtë:

Debi	Paraja	€1 milion	
Kredi	Kredia - detyrim financiar		€1 milion

Viti i përfunduar me 31 dhjetor 2021

Hypatia sh.a regjistron shpenzimet e interesit si në vijim:

Debi	F/H - shpenzim i interesit	€45,454	
Kredi	Kredia - detyrim financiar		€45,454

*Njohja e interesit të pagueshëm për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021 (\$0.25 milionë/5.5).*



Më 31dhjetor 2021 paguhet interesi dhe bëhet shënimi i mëposhtëm:

Debi	Interesi – detyrim financiar	€41,667
Kredi	Paraja	€41,667

*Njohja e pagesës së interesit për detyrimin financiar për vitin 2021 (\$0.25 milionë /6).*

Në 31dhjetor 2021, kredia regjistrohet në \$5 milionë/6, pra €833,333, që sjell një fitim nga këmbimi prej \$166,667. Përveç kësaj, një fitim i mëtejshëm nga këmbimi prej €3,787 lind nga përkthimi i interesit të paguar (€45,454 - €41,667). Për rrjedhojë, fitimi total i këmbimit është €170,454.

c) SNK 37 paragrafi 14, thotë se një entitet duhet të njohë një provizion nëse dhe vetëm nëse:

- i. një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv/tërthortë) ka lindur si rezultat i një ngjarjeje të kaluar (ngjarja detyruese),
- ii. pagesa për shlyerjen e detyrimit është e mundshme ('më shumë gjasa po se sa jo'), dhe
- iii. shuma mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Një ngjarje detyruese është një ngjarje që krijon një detyrim ligjor ose konstruktiv/tërthortë dhe, për rrjedhojë, rezulton që një entitet nuk ka alternativë reale përveç shlyerjes së detyrimit.

Në datën e pasqyrave financiare nuk kishte asnjë detyrim aktual për Huggins sh.a. Asnjë padi nuk ishte ngritur në lidhje me aksidentin. Nuk ishte ende e mundshme që do të kërkohej një dalje burimesh për të shlyer detyrimin. Kështu që nuk kërkohej asnjë provizion.

Huggins sh.a mund të ketë nevojë të shpalos një detyrim kontigjent. SNK 37 përkufizon një detyrim kontigjent si:

(a) një detyrim i mundshëm që ka lindur nga ngjarje të kaluara dhe ekzistenca e të cilit do të konfirmohet nga ndodhja ose jo e ngjarjeve të pasigurta të së ardhmes; ose

(b) një detyrim aktual që ka lindur nga ngjarje të kaluara, por nuk njihet sepse:

- (i) nuk ka gjasa që të ndodhë një dalje burimesh për të shlyer detyrimin; ose
- (ii) shuma e detyrimit nuk mund të matet me besueshmëri të mjaftueshme.

SNK 37 kërkon që entitetet nuk duhet të njohin detyrim kontigjente, por duhet t'i shpalosin, përveç rastit kur mundësia e një daljeje burimesh ekonomike është e largët. Duket se Huggins sh.a duhet të shpalos një detyrim kontigjent. Fakti që natyra dhe shtrirja reale e dëmeve, duke përfshirë nëse ato kualifikohen për kompensim dhe detajet e ndonjë kompensimi mbetën për t'u vendosur, të gjitha treguan nivelin e pasigurisë që lidhet me rastin. Shkalla e pasigurisë nuk është e tillë që mundësia e daljes së burimeve të mund të konsiderohet e largët. Po të ishte kështu, nuk do të ishte kërkuar asnjë shpalosje sipas SNK 37.

Kështu, kushtet për njohjen e një detyrimi nuk plotësohen. Megjithatë, për një detyrim kontigjent duhet të jepet informacion shpjegues siç kërkohej nga SNK 37. Rikuperimi i mundshëm i këtyre kostove nga siguruesi kërkon shqyrtimin nëse duhet të jepet informacion shpjegues për një pasuri kontigjente. Duke pasur parasysh statusin e raportit të ekspertit dhe se çdo informacion nëse ka gjasa të përfshihet gjyqësori nuk do të jetë i disponueshëm deri në vitin 2021, kjo pasuri kontigjente ka gjasa por nuk është e mundshme. Si i tillë, nuk duhet të përfshihet asnjë shënim shpjegues për pasurinë kontigjente.

d)

Kredia duhet të klasifikohet si detyrim afatshkurtër. Sipas SNK 1 *Paraqitja e pasqyrave financiare*, një detyrim duhet të klasifikohet si afatshkurtër nëse duhet të shlyhet brenda 12 muajve pas datës së pasqyrës së pozitës financiare.

Nëse një huamarrës shkel një dispozitë sipas një marrëveshjeje kredie afatgjatë në ose përpara datës së pasqyrës së pozitës financiare, në mënyrë që kredia bëhet e pagueshme menjëherë në tërësi, kredia klasifikohet si afatshkurtër edhe nëse banka është pajtuar, pas datës së pasqyrës së pozitës financiare, për të mos kërkuar pagesë në tërësi si pasojë e shkeljes së kushteve të kontratës. Mospagimi i pagesës së kistit në nëntor 2021 përfaqëson një dështim që mund të kishte çuar në një kërkesë nga banka për të shlyer të gjithë shumën e kredisë menjëherë. Meqenëse banka hoqi dorë pas datës së pasqyrës së pozitës financiare, Ghez sh.a nuk kishte të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë pagesën për të paktën 12 muaj pas datës së pasqyrës së pozitës financiare siç kërkohet nga standardi në mënyrë që të klasifikohet si detyrim afatgjatë.

Ghez sh.a duhet gjithashtu të marrë parasysh ndikimin që do të kishte një kërkesë për pagesë të menjehershme të kredisë në statusin e vijimësisë. Nëse statusi i vijimësisë është i diskutueshëm, atëherë Ghez sh.a a do të duhet të japë shenime shpjeguese shtesë rreth pasigurisë dhe rezultateve të mundshme. Nëse Ghez sh.a pushon së qeni një aktivitet në vijimësi, atëherë pasqyrat financiare duhet të përgatiten në bazë të likuidimit.

5.

(a) Hawking sh.a zotëron pasuri të caktuara afatgjata, të cilat janë në një zonë zhvillimi dhe mbahen me kosto minus zhvlerësimi. Këto pasuri u blenë për €2,000,000 më 1 janar 2020 dhe zhvlerësohen në bazën lineare gjatë jetës së tyre të dobishme prej dhjetë vjetësh. Një rishikim i dëmtimi u krye më 31 dhjetor 2021 dhe rrjedhat e parasë të parashikuara në lidhje me këto pasuri ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2025
<b>Rrjedhat e parasë</b>	<b>€250,000</b>	<b>€400,000</b>	<b>€550,000</b>	<b>€500,000</b>

Kompania përdor një normë skontimi prej 8%. Qeveria si rezultat i një skeme për ndihma ekonomike ka deklaruar se mund të kompensojë kompaninë për çdo humbje në vlerë të pasurive deri në 20% të humbjes nga dëmtimi.

Hawking sh.a mban një pasuri tjetër afatgjatë, e cila u ble për €5,000,000 më 1 janar 2020 me një jetë të dobishme të pritshme prej 10 vjetësh. Më 31 dhjetor 2020, ai u rivlerësua në €4,700,000. Më 31 dhjetor 2021, pasuria u rishikua për dëmtim dhe u vlerësua se shuma e saj e rikuperueshme ishte €3,000,000.

Hawking sh.a u angazhua në fillim të vitit financiar për të shitur një pronë që është duke u mosshfrytëzuar pas rënies ekonomike. Si pasojë e rënies ekonomike, prona nuk u shit në fund të vitit. Prona u tregtua në mënyrë aktive, por nuk kishte oferta të arsyeshme për blerjen e pronës. Hawking sh.a shpreson se rënia ekonomike do të ndryshojë në të ardhmen dhe për këtë arsye nuk ka ulur çmimin e pronës.

Shënim: Faktorët e mëposhtëm të skontimit mund të jenë relevant.

Viti	Faktori i skontimit @ 8%
1	0.9259
2	0.8573
3	0.7938
4	0.7350

**Kërkohet:**

**Diskutoni duke treguar llogaritjet se si të kontabilizoni çdo dëmtim të mundshëm të pasurive afatgjata të mësipërme në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021. (15 pikë)**

b) Eratosthenes sh.a mori hua €50,000,000 më 1 janar 2021 kur norma efektive e interesit në treg ishte 4%. Më 31 dhjetor 2021, Eratosthenes sh.a mori hua tjetër prej €49,111,790.27 kur norma efektive e interesit në treg ishte 6%. Të dy huatë janë të ripagueshme më 31 dhjetor 2024 dhe të gjitha shumat e interesave si dhe kryegjëja paguhet në atë datë.

**Kërkohet:**

**Diskutoni kontabilitetin për detyrimet financiare të mësipërme sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar duke përdorur koston e amortizuar dhe duke përdorur gjithashtu vlerën e drejtë me 31 dhjetor 2021. (5 pikë)**

5.

a)

Vlera kontabël e një pasurie mund të mos rikuperohet nga aktiviteti i ardhshëm i biznesit. Kudo që ekzistojnë tregues të dëmtimit, duhet të bëhet një rishikim për dëmtim. Kur identifikohet dëmtimi, një zbritje e vlerës kontabël në vlerën e rikuperueshme duhet të ngarkohet si shpenzim i menjëhershëm në pasqyrën e të ardhurave. Duke përdorur një normë skontimi prej 8%, vlera në përdorim e pasurive afatgjata është:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2025
Rrjedhat e parasë	€250,000	€400,000	€550,000	€500,000
Faktori i skontimit	0.9259	0.8573	0.7938	0.7350
Vlera e tanishme	231,475	342,920	436,590	367,500

Me 31 dhjetor 2021 vlera në përdorim e pasurisë është €1,378,485, përderisa vlera bartëse (kontabël) është €1,600,000 (€2,000,000 - €400,000). Zhvlerësimi vjetor është 200,000 x 2 vite.

Andaj pasuria është e dëmtuar për €221,515. (€1,600,000 - €1,378,485).

Kompensimi i marrë në formën e rimbursimeve nga dëmshpërblimet qeveritare regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse kur kompensimi bëhet i arkëtueshëm sipas SNK 37 *Provizionet, detyrimet kontingjente dhe pasuritë kontingjente*. Kompensimi trajtohet si ngjarje e veçantë ekonomike dhe kontabilizohet si e tillë. Deri me tani qeveria ka deklaruar vetëm se mund të rimbursojë kompaninë dhe për këtë arsye nuk duhet të njihet si pasuri.

Për një pasuri të rivlerësuar, humbja nga dëmtimi trajtohet si një ulje e rivlerësimit. Humbja vendoset fillimisht kundrejt çdo rezerve të rivlerësimi dhe bilanci i humbjes trajtohet më pas si shpenzim në fitim ose humbje. Fitimi nga rivlerësimi dhe humbja nga dëmtimi do të trajtohen si më poshtë:

Pasuri para rivlerësimit në €4,700,000 me 31 dhjetor 2020 kishtë vlerë bartëse prej €4,500,000 (€5,000,000 - €500,000), dhe rezerva e rivlerësimit ishte €200,000. Pas rivlerësimit me 31 dhjetor 2020 pasuria kishtë jetë të mbetur të përdorimit prej 9 viteve dhe zhvlerësim vjetor prej €522,222 (€4,700,000 / 9 vite). Me 31 dhjetor 2021 vlera bartëse e pasurisë ishte €4,177,778, përderisa shuma e rikuperueshme ishte €3,000,000 dhe një humbje nga dëmtimi prej €1,177,778 duhet të njihet.

Humbja nga dëmtimi prej €1,177,778 ngarkohet fillimisht ndaj rezerves së rivlerësimit prej €200,000 dhe pjesa e mbetur prej €977,778 do të ngarkohet në fitim ose humbje.

Një plan i menaxhmentit për të nxjerrë jashtë përdorimit një pasuri ose grup pasurish për shkak të mosshfrytëzimit është një tregues i dëmtimit. Kjo zakonisht do të jetë shumë kohë përpara se të plotësohen kriteret e mbajtura për shitje sipas SNRF 5 *Pasuritë joqarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera*. Pasuritë ose Njësitë Gjeneruese të Parasë do të testohen për dëmtim kur merret vendimi për ti shitur. Testi i dëmtimit përditësohet menjëherë përpara klasifikimit sipas SNRF 5. SNRF 5 kërkon që një pasuri e mbajtur për shitje të matet në vlerën më të ulët të vlerës kontabël dhe vlerës së drejtë minus kostot e shijes. Pasuritë afatgjata të mbajtura për shitje

dhe grupet e nxjerra jashtë përdorimit rimaten me vlerën më të ulët midis vlerës kontabël ose vlerës së drejtë minus kostot për shitje në çdo datë të bilancit nga klasifikimi deri në nxjerrjen jashtë përdorimit. Procesi i matjes është i ngjashëm me atë që ndodh në klasifikimin si të mbajtur për shitje. Çdo tejkallim i vlerës kontabël mbi vlerën e drejtë minus kostot e shitjes është një humbje e mëtejshme nga dëmtimi dhe njihet si humbje në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në periudhën aktuale. Vlera e drejtë minus kostot e shitjes mbi vlerën kontabël injorohet dhe asnjë fitim nuk regjistrohet në klasifikim. Pasuria afatgjatë ose grupi i nxjerrjes jashtë përdorimit nuk mund të rritet mbi vlerën e tij kontabël të mëparshme (të paradëmtimit), të rregulluar për zhvlerësimin, që do të ishte aplikuar pa dëmtimin. Fakti që pasuria po tregtohet me një çmim që tejkalon vlerën e tij të drejtë mund të nënkuptojë se pasuria nuk është i disponueshëm për shitje të menjëhershme dhe për këtë arsye mund të mos plotësojë kriteret për "të mbajtur për shitje".

**b)**

Duke përdorur koston e amortizuar, të dyja detyrimet financiare do të rezultojnë në nga një pagesë të vetme, të cilat janë identike dhe paguhen në të njëjtën kohë në të ardhmen €58,492,928.00

- Kredia €50,000,000 x 1.04<sup>4</sup> = €50,000,000 kryegjeja + €8,492,928.00 interesi. Total €58,492,928.00.
- Kredia € 49,111,790.27 x 1.06<sup>3</sup> = € 49,111,790.27 kryegjeja + € 9,381,137.73 interesi. Total €58,492,928.00.

Megjithatë, vlerat kontabël në 31 dhjetor 2021 do të ishin të ndryshme edhe pse detyrimi më 31 dhjetor 2021 do të ishte i njëjtë.

- Kredia €50,000,000 do të kishte vlerë kontabël prej €52,000,000 (€50,000,000 kyegjeja + €2,000,000 interesi).
- Kredia €49,111,790.27 do të kishte vlerë kontabël prej €49,111,790.27 (€49,152,542.37 kyegjeja + €0 interesi).

Nëse të dy kreditë do të mbaheshin me vlerën e drejtë, atëherë kredia fillestare do të mbahej me €49,111,790.27 duke treguar kështu një fitim neto prej €888,209.73 (shpenzimet e interesit prej €2,000,000 dhe fitimi i parealizuar prej € 2,888,209.73).